



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 34.

Prishtinë, më 26.2.2019, në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Haxhi Shala, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Shinik, Slobodan Petroviç, Duda Balje dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Igor Simiq, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljeviq dhe Zoran Mojsilović.

Pjesëmarrës tjerë: Senad Karaahmetovic OSBE; Pleurat Kurti EUSR; Ndiriçim Çekaj KDI; Zijush Ahmeti KSZ dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Personeli për mbështetjen e komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Xhelal Sveçla**, zëvendëskryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit të mbajtura me dt. 12.2.2019;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike, me raport amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
4. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**

Zëvendëskryetari, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e Komisionit e mbajtur me datë 12.2.2019;**

Zëvendëskryetari, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajture me 12.2.2019, pa vërejtje.

3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike, me raport amendamente të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**

Zëvendëskryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

4. Të ndryshme.

Zëvendëskryetari, në kuadër të detyrave të Planit të Punës të komisionit, është ftuar në takim ministri për Punë të Brendshme z. Ekrem Mustafa. Por për arsye të agjendës së ngarkuar, z. Mustafa ka kërkuar që takimi i komisionit të shtyhet për javën e ardhshme.

Anëtarët e Komisionit diskutuan, se në javën e parë të muajit mars janë disa ditë festive. siç është manifestimi i epopesë së UÇK-së e cila mbahet me 5 mars 2019. Për këto arsye, u propozua që ftesa e ministrit të shtyhet, pas datës 9 mars.

Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nori këtë:

Përfundim

Miratohet propozimi që në javën e dytë të muajit mars, të ftohet ministri për Punë të Brendshme, që të raportojë lidhur me temën: Rekrutimi i përfaqësuesve të komunitetit joshumicë, në bazë të konkursit të fundit të policisë së Kosovës.

Zëvendëskryetari, foli lidhur me organizimin e vizitës në KK të Zubin Potokut, e cila është caktuar disa herë, mirëpo për arsye të angazhimeve të anëtarëve të komisionit, nuk ka arrit të realizohet deri më sot.

Anëtarët e Komisionit u akorduan që stafi mbështetës i Komisionit me përkrahje të OSBE-së, të organizojnë vizitën në Zubin Potok, pas datës 9 mars 2019.

Duda Balje, diskutoi lidhur me mos përgjegjësin e ministrit z. Dalibor Jevtiq, i cili ka për obligim të raportojë lidhur me sigurimin e informatave të nevojshme dhe të cilat janë në interes të komuniteteve. Ajo shtoi se jemi në dijeni që z. Jevtiq e bojkoton punën, mirëpo përgjegjësia e tij është të përmbush obligimet e kësaj ministrie.

Për zgjidhjen e kësaj situatë, propozoi që ti drejtohem me shkrim kryeministrit z. Ramush Haradinaj, me kërkesë që të vihen kontakteve të bashkëpunimit reciprok me Komisionin .

Të mendimit të njëjtë ishin edhe deputeti Veton Berisha dhe Danush Ademi. Përveç tjerash, Veton Berisha, propozoi që të në të njëjtin muaj, të ftohet në raportim edhe ministri për Zhvillimi Rajonal z. Rasim Demiri.

Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

Në bazë të dispozitave të Shtojcës nr. 2.2 dhe nenit 65.7 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në pajtim me Planin e punës, ka paraparë takim me ministrin për komunitete dhe kthim Dalibor Jevtiq, lidhur me raportimin për çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e ministrit, me qëllim të sigurimit të informatave të nevojshme, që janë në interes të komuniteteve. Fushëveprimi i Komisionit është që të bëjë kontrollin e veprimtarisë së përgjithshme të kësaj Ministrie dhe kontrollin buxhetor lidhur me mjetet e shpenzuara.

Përpjekjet për vendosjen e bashkëpunimit reciprok, koordinimit dhe marrëveshjeve të përbashkëta të Komisionit dhe kësaj Ministrie, rezultuan të pasuksesshme.

Për shkak të shembujve të tillë të mosbashkëpunimit, ju lusim që ta përdorni autoritetin e juaj dhe t'i mundësoni Komisionit të Kuvendit realizimin e këtyre kontakteve, me qëllim të përmbushjes të obligimeve të tyre.

Komisioni kërkon që për zgjidhjen e këtij problemi t'i qaseni në mënyrë të përgjegjshme dhe të merret përgjigje për lëshimet e kësaj Ministrie.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

Përgatitur nga; Njësia mbështetëse e Komisionit

Zëvendëskryetar i Komisionit

Xhelal Sveçla